



ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-19-4346-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Shërbimet e përgaditjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së -Ritender - Vazhdim afati**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i OE "AMAZONA HOTEL SHPK & Faton Haziraj B.I."

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

BABIN MOST, pa nr. OBILIQ

(Adresa)

OBILIQ

(Vendi)

15000

(Kodi postar)

044 454 454

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

GANI FERIZI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@hotelamazona.com

(Adresa elektronike)



29.10.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Shërbimet e përgaditjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së -Ritender - Vazhdim afati.**

Njoftimi për kontratë (Ri-tenderimi) është bërë me datën 24.06.2019 ndërsa hapja publike është bërë më 15.05.2020.

Njoftimi mbi vendimin e AK është bërë më datë 01.07.2020 ku të pakënaqur me këtë vendim dhe në afat të rregullt kohorë kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.

Me datë 09.07.2020 AK ka publikuar njoftimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim andaj të pakënaqur me këtë vendim dhe të pakënaqur edhe me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, me datë 17.07.2020 kemi parashtruar Ankesë në OSHP.

Me datë 21.08.2020 OSHP ka lëshuar vendimin për kthim të lëndës në rivlerësim.

Më datë 05.10.2020 AK ka publikuar njoftimin mbi Vendimin e AK-së lidhur me rivlerësimin e tenderit.

Të pakënaqur me këtë vendim dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 12.10.2020 kemi parashtruar pran AK-së Kërkesë për Rishqyrtim.

Me datë 19.10.2020 AK na e ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si të pabazuar, andaj të pakënaqur me vendimin e tyre, po iu drejtohem OSHP-së me këtë ankesë.

Kriteri për vlerësim ka qenë **Tenderi i Përgjegjshëm me Çmim më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Hapja publike ka ndodhur me datë 15.05.2020. Në bazë të procesverbalit të hapjes publike shihet se nuk është evidentuar ndonjë vërejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Me datë 12.10.2020 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK-së ndërsa me datë 19.10.2020 AK na ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si të pabazuar.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së rreth shqyrtimit të kërkesës tonë për rishqyrtim dhe në afat të rregullt kohorë, parashtrojmë ankesë pran OSHP-së.

Vendimin e AK për refuzim të kërkesës e gjeni të bashkangjitur.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka shkelur këto dispozita të LPP-së:

1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,
2. AK ka shkelur nenin 56.3 të LPP-së,
3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RRUOPP-së,
4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së,
5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,
6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RRUOPP-së,
7. AK nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së të datës 05.10.2020 me nr.475/20

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit të tenderëve ka bërë trajtim jo të barabartë të OE. Më saktësisht ka bërë diskriminim ndaj Grupit të OE "AMAZONA HOTEL SHPK & Faton Haziraj B.I." pasi që edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe ato të njoftimit për kontratë të cilat i ka vërtetuar edhe OSHP me vendimin 475/20, AK prapë pa të drejtë na ka eliminuar si të papërgjegjshëm. Përpos kësaj ne kemi pasur çmimin më të ulët në krahasim me OE që AK e ka shpallur fitues për 72,707.20€ apo përafërsisht për 9% më të ulët dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Përpos kësaj AK na ka eliminuar nga konkurrenca dhe na ka diskriminuar duke aplikuar kërkesa që nuk i ka pasur fare në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Kjo është plotësisht në kundërshtim me parimet e prokurimit publik mbi trajtimin e barabartë të OE dhe vlerësimin e mirëfilltë të tenderëve. Për këtë gjë kemi kërkuar interpretim tek KRPP e cila ka lëshuar edhe interpretim ligjorë ku e sanksionon rreptësisht eliminimin e apo diskualifikimin e ndonjë OE për kërkesa që nuk i ka pasur më parë të vendosura si kritere tek dosja e tenderit.

Bazuar në nenin 7 të LPP-së kjo konsiderohet diskriminim i një OE dhe favorizim i një tjetri OE e që konsiderohet shkelje e parimeve bazë të prokurimit mbi trajtimin e barabartë, pra shkelje e plot e nenin 7 të LPP-së.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 56.3 të LPP-së pasi gjatë vlerësimit të tenderëve ka aplikuar kërkesa që nuk i ka pasur fare në dosjen e tenderit. Ky nen shumë qartë e thotë se:

Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet

nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

AK gjatë vlerësimit herën e parë dhe sqarimit të tenderëve na ka kërkuar që të ia dërgojmë në kopje fizike të gjitha dëshmitë që i kemi dorëzuar si të skanuara në tenderin tonë. Disa prej dëshmive kemi hezitur të ja dërgojmë sepse janë materiale shumë sensitive (*diploma të viteve para 1999*) dhe në rast të dëmtimit apo humbjes së tyre, mundësia e pajisjes prapë me të tilla është zero. Pavarësisht kësaj ne ia kemi ofruar si origjinale në shikim ndërsa si të noterizuara në posedim, por Zyrtari Kryesor i Prokurimit (ZKP) si duket nuk u mjaftuaka me kaq. Përpos kësaj prapë ka kërkuar nga disa kompani që ne kemi pasur referencat e tyre mbi realizimin me sukses të projekteve e që i kemi paraqitur edhe në listën e kontratave ku nga to ka kërkuar transaksione bankare, fletëpagesa dhe dëshmi të ngjashme edhe pse këto nuk kanë qenë kërkesa të dosjes së tenderit.

Bazuar në këtë ne iu kemi drejtuar KRPP me një kërkesë për interpretim dhe këta të fundit kanë leshur edhe interpretim zyrtarë ku ndër të tjera thuhet se:

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim:

Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton:

"3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Sipas paragrafit 3 të nenit 56 të lartcekur, në asnjë mënyrë AK nuk i lejohet të diskualifikojë ndonjë OE për ndonjë dëshmi që nuk është specifikuar në dokumentet e tenderimit.

Për të gjithë operatorët ekonomik që pretendojnë se AK nuk ka bërë vlerësimin e tenderëve në përputhje me kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit, si dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor, LPP ka paraparë mjetet juridike për t'i atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së).

Me respekt,
Arbnora Cakolli-Luzha,
Kordinatore e Departamentit të Rregullave-KRPP.

Pra siç po shihet, veprimi i AK-së që ka kërkuar dokumente dhe prova shitesë që nuk i ka pasur si kërkesa në dosjen e tenderit e të cilat nuk i parasheh as ligji përkatësisht neni 69.4.2.ii i LPP-së që të jenë si kërkesa të dosjes, është veprim plotësisht i kundërligjshëm dhe shkelje e parimeve bazë të prokurimit mbi respektimin e "**kërkesave dhe kritereve**" të vendosura paraprakisht në dosjen e tenderit.

Tani ne s'kemi si të mos mendojmë ndryshe veç se AK ka shkelur plotësisht nenin 56 të LPP-së me rastin e vlerësimit dhe sqarimit të tenderëve duke aplikuar kërkesa që nuk i ka pasur fare në dosjen e tenderit.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit, krahasimit dhe sqarimit të tenderëve nuk ka respektuar fare pikën 4 të këtij neni. Ky nen shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

AK nuk ka vepruar aspak sipas këtij neni dhe na ka eliminuar nga konkurrenca edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat dhe kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit.

Arsyetimi i AK-së lidhur me eliminimin tonë duket kështu:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

1. Kompania „Amazona Hotel” shpk & Faton Haziraj B.I. nuk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit, njoftimin për kontratë si në vijim: në dosjen e tenderit , njoftimin për kontratë është kërkuar

Këtë arsyetim të AK-së mbi eliminimin tonë nga konkurrenca që është plotësisht i pa-bazuar po e sqarojmë për secilën kërkesë të dosjes dhe secilin arsyetim të dhënë nga AK:

Arsyetimi 1:

9.1& 9.2(Kapacitetet teknike profesionale) nr.11

O.E. duhet të dëshmoj stafin profesionalin 4 kuzhinjerë (2 nga kuzhinjeret të jenë të kualifikuar diploma dhe 2 për gjellëbërës)në fushën e gastronomisë dhe min një (1) inxhinjer të diplomuar të teknologjisë së ushqimit master apo bachelor.

Dëshmi e kërkuar dokumentare nr.11.

Listen e stafit profesional e vulosur dhe nënshkruar nga O.E. duke ofruar dëshmi për secilin kuzhinjer dhe gjellëbërës dhe inxhinjer të teknologjisë ushqimore .Kopjet e diplomave për kuzhinjer, për gjellëbërës, dhe për inxhinjer, CV,kopja e kontratave të punës ose ose para kontrata me emër të projektit në fjalë.

Lista e stafit që ka ofertuar Operatori Ekonomik „Amazona Hotel & Faton Haziraj BI “ i mungojnë dy (2) gjellëbërës me diplomë,CV,kontrata e punës.

Duke pasur parasysh që kërkesa e AK-së në dosjen e tenderit ka qenë shumë e qartë që të dëshmohet me diploma DY GJELLËBËRËS ka të bëjë me rastin se në kuzhinën tonë në AKSP 90% e ushqimit janë gjella dhe kjo ka qenë edhe arsyeja e kërkeses tonë pasi që ne nuk kemi këtu HOTEL me yje që na duhen vetem kuzhinjer ,mirpo kuzhinjer kemi kërkuar për raste kur kemi takime specifike dhe dreka zyrtare të nivelit më të lartë si psh .OSCE,

Ambasada të ndryshme në vizitë, vizita nga qeveria , USAID, trajnime të ndryshme regjionale etj.

Dy nga ofertuesit tjerë kanë pasur gjellëbërës me diploma të lëshuar nga institucionet e Republikës së Kosovës .

Sqarimi 1: Ne në tenderin tonë kemi paraqitur këtë listë të stafit ku bëjnë pjesë edhe kuzhinjerët:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Moshë	Përgatitja profesionale	Vitet e përvojës së punës	pozicioni në kompani
1	Beqir Nika	1962	Kuzhinier	30 vite	Kuzhinier
2	Abdullrahman Gahindol	1963	Kuzhinier	33 vite	Kuzhinier
3	Fahri Kajtaku	1972	Kuzhinier	26 vite	Kuzhinier
4	Maradin Dini	1964	Kuzhinier	22 vite	Kuzhinier
5	Sultrane Bajram	1984	Imbuesi Ushqimor	5 vite	Managjeri për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit
6	Tarik Camgor	1979	Kuzhinier	2 vite	Kuzhinier
7	Mehdi Terup	1983	Kuzhinier	10 vite	Kuzhinier
8	Afrim Hysoni	1977	Kuzhinier	23 vite	Kuzhinier

Të shtatë kuzhinierët që ne i kemi paraqitur të gjithë janë me diploma shkollore dhe me program të zgjeruar të kuzhinës. Niveli i diplomës së gjellëbërësit është vetëm një program që mësohet gjatë shkollimit për kuzhinier andaj ky arsyetim është i pakuptimtë sepse diploma e kuzhinierit është shumë herë më e avancuar se ajo e gjellëbërësit pasi që një kuzhinier i diplomuar ka mësuar për të gjitha specialitetet e kuzhinës ndërsa një gjellëbërës është i përgatitur vetëm për një program pra atë të gjellërave. Për këtë qëllim ne ju kemi drejtuar me një kërkesë për sqarim QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE TË DIPLOMAVE pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave të Republikës së Kosovës të cilët na kanë kthyer përgjigje decideve që titulli Gjellëbërës hynë(përfshihet) në kategorinë e diplomës për Kuzhinier. Shihe në vazhdim përgjigjen e këtij institucioni lidhur me këtë çështje.

Kërkesë ,Drejtuar: Qendres Kombetare per Njohje/Barasvlere dhe Informim Akademik (NARIC)

Inbox



Hotel Amazona <info@hotelamazona.com>
to Kumrije

z. Kumrije Gagica, Udhëheqese e Qendres Kombetare per Njohje dhe Informim Akademik

Si Qender perqjegjese per Njohje dhe Informim Akademik, ju drejtohem me kerkesen qe te me jepni nje sqarim pak me te zgjeruar se titulu gjellberes a hyn ne kategoria e q Nje perqigje e juaj si Qender Kompetente do te na ndihmone te shume, per ti sqaruar disa paqartesit ne lidhje me nje tender qe eshte ne procedure te rivlersimit. Me respekt:



Amazona Hotel
Phone: +38344197415 , +38349454454
Website: www.hotelamazona.com

Kumrije Gagica <kumrije.gagica@rks-gov.net>
to me

Te nderuar,

Ndjes per vonesen ne perqigje. Natyrisht qe edhe titulli gjellberes hyn ne kategoria e diplomes per "kuzhinier".

Me respekt,
Kumrije Gagica
Udhëheqese në NARIC Kosova

On 24 Aug 2020, at 11:34 AM, Hotel Amazona <info@hotelamazona.com> wrote:

Këtë fakt të konfirmuar nga QKNIA-ja për diplomat e kuzhinierëve ne ia kemi dërguar me kohe gjate procesit të ri-vlerësimit AK-së, por ata nuk e kanë marrë për bazë fare. Arsyetimi që kanë dhënë duke apostrofuar emra të ambasadave dhe organizatave tjera botërore është lojë e ngritjes gjoja të rëndësisë së projektit. Ne jemi të tej kualifikuar me staf dhe nisur nga fakti

që kërkesa për gjellëbërës është kriter kualifikues, atëherë ky kusht konsiderohet i pranuar sipas LPP-së. Ekziston edhe sqarimi se çdo here pranohet një kriter kur e arrin nivelin e kërkuar ose niveli i ofruar është më i avancuar se kërkesa. Nisur nga kjo AK ka vlerësuar në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e përcaktuar më herët në dosje të tenderit duke vepruar në kundërshtim të plotë edhe me nenin 59.4 të LPP-së.

Arsyetimi 2:

2. 13. Operatori ekonomik duhet të ofrojë listën për kontratat të natyrës së njëjtë në fushën e shërbimeve - gastronomisë, në rast të konkurrencës Lideri duhet të ketë kontrata të shërbimeve së paku 60% të vlerës të shërbimeve të kërkuara (shërbime- përgatitje dhe servime të ushqimit), me institucione publike apo privat gjatë tre (3) viteve të fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) minimum në vlerë min 950,000.00 €.

13. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë listën e kontratave të natyrës së njëjtë në fushën e shërbimeve - gastronomisë, gjatë tri viteve të fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, minimum tri referenca pozitive duke ju bashkangjitur listës së kontratave. Lista e kontratave të nënshkruar dhe vëlosur nga Operatori Ekonomik. Në rast konkurrencës lideri duhet të ketë në emër të OE referencat me vlerë 60% të dëshmuara me referencat të

suksesshme, në kopje në rast konkurrencës, të nënshkruar dhe vëlosur nga Autoritetet përkatëse, për shërbimet e pranuar, të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e shërbimeve dhe vendin e realizimit të shërbimeve. a. Kur shërbimimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (në referencat të jete e cekur vlera e shërbimeve) të lëshuara nga autoriteti i tillë. b.

Kur shërbimimi është bërë për një blerës privat, duhet të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (në referencat të jete e cekur vlera e shërbimeve) të lëshuara nga blerësi i tillë. Vërejtje Asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e shërbimeve ose raportet e pranimeve të shërbimeve.

Lista e referencave që ka ofertuar Operatori Ekonomik „Amazona Hotel & Faton Haziraj BI nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit.

Referenca e cekur në listë e referencave me OSCE me vlerë 116,888.70 pas kërkesës sonë për sqarime me datë 24.09.2020 (pasi ka qenë nga viti 2014) kemi kërkuar të na sjell pagesat apo transferet bankare, faturat për tri vitet e fundit (qeshor 2016- qeshor 2019) nuk na ka sjell fare, dhe ka mospërputhshmëri (diskrepancë) njëra me tjetren në shumë. OE që ka ofertu në ofertë elektronike vlera e referencës është 116,888.70 euro ndërsa kur kemi kërkuar sqarim për referencë për vërtetueshmërinë na ka dërguar në mënyrë elektronike dhe fizike me shumë tjetër 116,88,70 euro kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme dhe e manipuluar.

Referenca e lëshuar nga organizata joqeveritare PEN me vlerë 108,316.50 nuk është e pranueshme për AK pasi pas sqarimeve që ju kemi drejtuar kësaj Organizate me datë 24.09.2020 z. Bujar Fejzullahu nuk është përgjigjur fare.

Gjithashtu ne si AK kemi kërkuar sqarim me datë 24.09.2020 lidhur me referencën që ka prezentuar në listën e referencave në vlerë 52,767.00 nga firma Apetiti shpk të na dëshmojë me transfere bankare apo me fatura lidhur me këtë referencë ka refuzuar me dëshmu, por na shkruar në e-mail se në Kosovë referencë bënë edhe ndërrimi MALL me MALL e ku Ligji i Prokurimit nuk e njeh një të tillë dhe janë të papranueshme referencat e tilla.

Referenca e prezentuar në listen nga NEËCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C me vlerë 1,049,615.00 pas kërkesës së sqarimeve me datë 24.09.2020 që të na dëshmojë me faturë apo me transfer bankar ky OE nuk është përgjigjur fare.

Referenca Instituti Demokracia për Zhvillim në si AK kemi kërkuar sqarim me datë 24.09.2020 të na informon lidhur me referencën në vlerë 24.320,00 euro nuk kemi marr asnjë përgjigje dhe pas sqarimeve që kemi kërkuar për verifikim nuk janë të njëjta referencat dhe kanë mospërputhshmëri (diskrepancë) njëra me tjetren kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme dhe e manipuluar.

Referenca nga Ministria e Bujqësisë në vlerë 26.720,00 euro kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.09.2020 dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ata dhe kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme.

Referenca nga Emona shpk kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.09.2020 dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ata dhe kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme.

Referenca nga Pestova shpk kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.09.2020 dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ata dhe kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme.

Referenca nga OJQ LËVIZJA KOHA kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.09.2020 dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga ata dhe kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme.

Gjithashtu edhe për referencat tjera që ju kemi shruar më heret nuk na ka dëshmu që ka kryer shërbime të ushqimit pas kërkesës sonë në bazë të nenit 72 për shumën e paraqitur në referencë.

Konkluzioni përfundimtar i AKSP-së lidhur me referencat e konzorciumit Amazona Hotel & Faton Haziraj B.I nuk e kanë përmbushë listen referencave për tri vitet e fundit (950,000.00) dhe as lideri 60% të totalit por as partneri siq e ka qenë e kërkuar në dosjen e tenderit.

Ky arsyetim është i pabazuar dhe deklaram i pa drejtë i ZKP-së sepse dispozitat e ligjit e tregojnë shumë qartë kur AK ka të drejtë të bëjë sqarimin e dokumenteve. Sipas nenit 69.4.2.ii shumë qartë sqarohet se cilat dokumente janë të nevojshme për dëshmim të një shërbimi që është kryer ndaj një blerësi privat. Po ashtu edhe në kërkesën e dosjes së tenderit ka qenë shumë qartë e cekur se nevojitet lista e kontratave dhe referenca pozitive. Ne i kemi plotësuar të dy këto kushte si dhe pas kërkesës për sqarim ia kemi ofruar për verifikim secilin dokument në formën origjinale. AK përkatësisht Zyrtari Kryesor i Prokurimit (ZKP) nuk i ka pranuar sepse dëshironte ti ndalte si dëshmi origjinale në AK dhe atë pa lëshuar asnjë procesverbal mbi dokumente e pranuar. Më pas të gjitha këto ja kemi dorëzuar të noterizuara andaj nuk ka pasur se çka të kontestohet në këtë rast. Kërkesa për transaksione bankare është e paligjshme për këtë arsye nuk ju kanë përgjigjur kompanitë që i ka kontaktua pa të drejtë dhe kundërligjshëm ZKP-ja. Ja forma se si ka kërkuar sqarime nga këto kompani ZKP i AK-së:

Përsëritje i nderuar,

Po ju rishkruaj përsëri lidhur me referencën që e keni lëshuar për Ndërmarrjen Hoteliere „AMAZONA“.

Ju lutem të na i skenoni transaksionin bankar (pagesa përmes bankës) si dhe fatura për referencën në shumë 62.767,00 euro.

Pasi që kjo reference është lëshuar nga firma APETIT shpk me datë 01.06.2019 për NH „AMAZONA“ dhe sipas LPP ne si AK duhet ta verifikojm.

Pasi që Autoriteti jonë AKSP-ja e ka shpallur një aktivitet të prokurimit me titull „Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së“ ritender dhëna të lartëcekura për verifikim.

Të bashkangjitur gjeni referencën dhe kontratën.

Faleminderit për mirëkufim, pres përgjigje në afat brenda dy diteve në të kundërtën nuk mund të mirret si referencë me të dhëna të sakta.

Ju lutem na konfirmoni e-mailin e pranuar.

Me respekt

Bekim Dakaj

Menaxher i Prokurimit - Procurement Manager

Akademia e Kosovës për Siguri Publike - Kosovo Academy for Public Safety

Rr./Str. Gjergj Kastrioti Skënderbeu p.n./n.n.

42000 Vushtri

Tel.: +383 (0)28 590 070 lok./ext. 280

E-mail: bekim.dakaj@rks-gov.net

Web: <http://aksp.rks-gov.net>

ZKP, me këtë kërkesë ka bërë edhe tejkallim të kompetencave sepse ka kërkuar diçka që nuk ishte e përcaktuar në dosje nga një kompani që s'ka kurrfarë raporti me AK-në. Kjo na ka sjellë edhe probleme në afarizmin e kompanisë tonë duke i irrituar klientët tanë me kërkesa të përsëritura ndaj tyre. ZKP në këtë rast ka luajtur rolin e personit hetues andaj kjo konsiderohet lirisht edhe vepër penale. Neni 72 i LPP-së shumë qartë e sqaron se cilat dokumente duhet sqaruar dhe si duhet sqaruar ato. Askund nuk lejohet që të kërkohen dokumente shtese në emër të sqarimit sepse kjo bie në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së si dhe e cenon edhe privatësinë e formës së të bërit biznes të kompanive dhe klientëve tanë. Nëse ZKP-AK ka dyshime për vërtetësinë e dokumenteve atëherë duhet tjetër qasje për verifikim. Si ka mundësi të dyshohet në një dokument origjinal të vulosur dhe të noterizuar nga organet e shtetit. Siguri absolute dhe plotësim të tekeve të tij ne nuk mundemi me i ofruar këtij zyrtari por nëse ky i fundit ka dyshime për çfarëdo lloj çështjeje rreth dokumenteve tona, e inkurajojmë që të i drejtohet institucioneve përkatëse lidhur me paqartësitë e veta që i ka. Asnjë justifikim real dhe argumentim objektiv nuk ka arritur ta paraqes dhe ta faktoj për kontestim të këtyre referencave, andaj nuk kemi se si të mos mendojmë ndryshe veç se ky ZKP ka interesa personale në kontraktimin e OE që edhe e ka shpallur kundërligjshëm fitues. Përpos kësaj për më shumë se një vit e gjysmë vazhdon ta zvarris kontraktimin me neve jo pse nuk jemi mirë me letra por po i konvenon duke ia vazhduar kontratën OE që tashmë edhe e ka ri-shpallur fitues. Me vet faktin se në dosjen e tenderit të publikuar në e-prokurim herën e parë tek deklarata nën betim e ka vendosur vet emrin e OE „Global Parajsa“ nënkupton se përgatitjen e tenderit e kanë bërë së bashku me këtë OE e që në kushte normale do të ishte argument i mjaftueshëm për hetim të bashkëpunimit të tyre.

Ja dëshmia që ndodhet në dosjen e tenderit të publikuar më 11.09.2019 nga AK:

Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [Nip Global Parajsa] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)

Përpos kësaj, sipas nenit 39 të RROUPP-së dhe 72 të LPP-së munden të kërkojnë sqarime vetëm për dokumentet e dorëzuara apo edhe për dokumente që mund të verifikohen objektivisht se kanë ekzistuar para tenderimit. Në asnjë mënyrë nuk munden të kërkojnë transaksione bankare, për verifikim të realizueshmërisë së kontratave. ATK i konsideron gjatë kontraktimeve edhe kryerjen e obligimeve ndaj një shërbimi me forma tjera të pagesës andaj jo çdo here transaksionet bankare vërtetojnë gjithçka. Pavarësisht këtyre ne i kemi të gjitha të evidentuara përmes transaksioneve bankare mirëpo me që nuk kanë qenë kërkesa të dosjes së tenderit dhe LPP-ja nuk e parasheh që duhet të dorëzohen, nuk kemi mundur të ua japim që ti kanë në dispozicion. Ne kemi ngarkuar edhe deklaratën nën betim ku jemi deklaruar se çdo informacion i ofruar është i saktë dhe i vërtet andaj nëse AK ka dyshime për ndonjë dokument duhet ta paraqes rastin tek krimet ekonomike apo prokuroria e shtetit e jo ta luaj vet rolin e këtyre institucioneve për gjoja verifikim të dokumenteve. Kjo është një fyerje e rëndë që na është bërë neve dhe klientëve tonë sepse çdo here kemi qenë dhe do jemi njëra ndër kompanitë më serioze në fushën e ofrimit të shërbimeve hoteliere dhe të gastronomisë. Kërkesën që AK e kishte vendosur më herët në dosjen e tenderit për dorëzim të transaksioneve bankare, OSHP ia ka larguar me vendim të formës së prerë andaj kërkesa për sqarim bie ndesh edhe me vendimin e OSHP-së. *(Shiko vendimet që i posedon AK dhe që ndodhen edhe në webfaqen e OSHP-së).*

Ne edhe një here deklarojmë se kontratat e tilla janë realizuar saktë sikur në listën e kontratave dhe i kemi dëshmuar edhe me referenca pozitive me çka e kemi përmbushur kushtin e dosjes së tenderit. Arsyet e dhëna nga AK në Letrën standarde për eliminim janë të pa bazuara dhe shumë tendencioze andaj si veprime bien ndesh plotësisht me nenin 59 të LPP-së.

Edhe në përgjigjen ndaj Kërkesës për Rishqyrtim, AK ka tentuar të manipuloj me faktet e dorëzuara nga ne në këtë kërkesë duke vepruar në kundërshtim të plotë me nenin 59 dhe 108/A të LPP-së. Atë që e ka thënë lidhur me mospërputhjen e vlerës së referencës së dorëzuar në tenderin me referencën e dorëzuar me rastin e dërgimit të dokumenteve për

sqarim sipas kërkesës së AK-së është e keq prezantuar duke tentuar ta bëjë të madhe pa asnjë arsye. Ja sqarimi: Ne para se ti dërgonim dokumentet e kërkuara nga AK për sqarim, nuk kishim mundësi ta gjenim referencën e tillë dhe për këtë arsye i kemi kërkuar OSCE-së që të na e jap edhe një here dokumentin e njëjtë. Për çudi në dokumentin e ri OSCE-së i kishte rrjedhur një gabim dhe në vend të vlerës **116,888.70€** e kishin shënuar vlerën **116,88.70€**.

Në rend të parë po shihet se është gabim teknik pasi që po të ishte vlera e referencës ajo e dyta, presja që ndan dhjetëshet me qindëshet nuk do duhej të ishte aty por do ishte në mes numrit 1 dhe 6. Për këtë ne tani po ua bashkëngjisim referencën e vërtet, atë të dorëzuar me kohë në tender të cilën e gjeni të bashkangjitur kësaj ankese edhe të noterizuar. Për të qenë edhe më bindës lidhur me vlerën e referencës, po ua bashkëngjisim edhe transferet bankare të OSCE-së që i ka realizuar në sipas kontratës e që tregojnë se vlera e referencës është ajo **116,888.70€**. Të bashkangjitur i keni transferet bankare nga Raiffeissen banka dhe ProCredit banka.

Ngjashëm AK e ka kontestua edhe referencën e “Institutit Demokracia në Veprim” për të cilën u kemi bashkangjitur referencën e noterizuar si dhe i keni edhe transaksionet bankare për të ju dëshmuar se në referencën e parë ka qenë një gabim teknik i bërë nga lëshuesi i referencës duke e përfshi edhe qarkullimin e vitit 2015. Kjo tregohet më së miri me referencën e noterizuar dhe krahasimin e tyre me qarkullimin bankarë të bashkëngjitur kësaj ankese.

Edhe ato që i ka thënë lidhur me mos pranimin e sqarimeve nga klientët tanë që i kanë leshur referencat është e pabazuar pasi që bazuar në nenin 59.2 të LPP-së AK nuk ka të drejt të kërkoj sqarime dhe të bëjë ndryshim material të tenderit. Në rastin tonë ka kërkuar dokumente tjera që sipas këtij neni, përbejnë ndryshim material të tenderit tonë. Edhe sa i përket asaj që AK e thotë rreth nenin 69.4 dhe 69.4.1 të LPP duket të jetë e pakuptimet sepse bazuar në ato që ne kemi dorëzuar si dëshmi për këtë kërkesë të dosjes e plotësojnë madje e tejkalojnë kushtin e kërkuar në dosje.

Tentimi për manipulim në emër të nenit 72 të LPP-së është po ashtu i pakuptimet sepse ky nen shumë qartë e thotë që munden të sqarohen vetëm dokumentet e dorëzuara ndërsa AK ka vepruar plotësisht në kundërshtim me këtë nen duke kërkuar dokumente shtesë të panevojshme të cilat madje i ka kërkuar edhe nga klientët tonë që nuk janë të përfshirë fare në këtë tender.

Prapë duam të ju theksojmë se po që se ky zyrtarë sheh diçka që i duket e falsifikuar siç e ka cek në refuzim të kërkesës për rishqyrtim, duhet të i drejtohet organeve kompetente për këtë çështje e jo ta luaj vet rolin tyre sepse përpos që nuk e njeh atë fushë, veprimi i tij përbënë edhe tejkalim të kompetencave për çka edhe Kodi Penal i Kosovës e konsideron vepër penale. Ne ju kërkojmë edhe juve si OSHP që për çfarëdo paqartësie, të na kontaktoni dhe ne do ju japim informata të mjaftueshme për të ju bindur se tenderi jonë i plotëson të gjitha kushtet e tenderit për tu cilësuar si i përgjegjshëm andaj kësaj radhe kërkojmë që të nxirret URDHËRESË për AK që detyrimisht ta respektoj vendimin e OSHP-së për rivlerësim të tenderit bazuar vetëm në kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e LPP-së të parapara për vlerësim të tenderëve.

Arsyetimi 3:

3.Mungojnë raportet (transaksionet) e pagesave nga banka për listat e kontratave të realizuara për tri vitete e fundit që ka qenë kërkesë e letres standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit sipas nenit 72 të LPP-së.

Ky arsyetim do të sqarohet tek pretendimi mbi shkeljen e nenit 72 mirëpo edhe këtu duam të ju sqarojmë se kërkesa e tillë nuk ka fare të bëjë me nenin 72 të LPP-së por është kërkesë shtesë në kundërshtim të plotë edhe me nenin 56.3 të LPP-së për qasje të pa-arsyeshme në afarizmin e kompanisë tonë dhe afarizmin e klientëve tonë. Pra komplet është arsyetim i pabazuar dhe si i tillë bie ndesh me dispozitat e LPP-së për sqarimin dhe verifikimin e dokumenteve të tenderit. Këtë kërkesë që më parë AK e kishte vendosur tek dosja e tenderit, ia ka larguar OSHP-ja përmes një vendimi andaj kërkitë rishtazi i saj përpos që është shkelje e dispozitave të ligjit, është edhe mos respektim dhe injorim i vendimit të OSHP-së. Vendimin e tillë AK e posedon në sirtarët e vet por i njëjti ndodhet gjithashtu edhe në webfaqen e OSHP-së.

Arsyetime 4:

4. 14. OE duhet të ofroj dëshmi

- Automjet i mbyllur min 2 copë ne emer te OE

Dëshmitë e kërkuara dokumentuara

14. Lista e mjeteve Dëshmitë

- Libreza e regjistrimit të automjeteve me validitet si dhe fotografit- kopje

Operatori Ekonomik „Amazona Hotel & Faton Haziraj BI nuk e përmbush këtë kriter sipas dosje së tenderit pasi që të gjitha automjetet janë pronë e kompanisë „APETIT shpk” dmth nuk janë në pronsi të Amazona Hotel.

Sai përket kërkesës për automjete OSHP-ja ka vendime të lëshuara që vetëm që ska qenë automjeti i rexhistruar e keni eliminuar operatorin ekonomik e lëre që me rastin tonë operatori ekonomik i mungojnë dy automjete.

Ky arsyetim nuk është i bazuar në LPP dhe po ashtu as në gjendjen reale të ofertës tonë. Ne kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë për këto automjete dhe kemi dorëzuar edhe marrëveshjen me pronarin e tyre për shfrytëzimin e tyre kundrejt një shume të caktuar të pagesës në formë qiraje. Nenin 69.8 shumë qartë e saktëson se: **Një operator ekonomik mund, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta.**

Ja marrëveshja për shfrytëzimin e pajisjeve të tilla:

KONTRATË MBI DHËNIEN AUROMJETEVE ME QIRA

Nr. Kontrates: 06/2019

E lidhur më datën: **01.06.2019** në mes të palëve kontraktuese: **APETIT SHPK**, nr. unik identifikues: **811106823**, Magjistratja Prishtinë-Mitrovicë, Km-1 si qiradhënësi, të cilën e përfaqëson **Destan Ferizi** dhe **Amazona HOTEL**, Nr. unik identifikues : **810129157**, **Babimoc-Obiliq** të cilën e përfaqëson **Gani Ferizi**, si qiramarrës dhe atë si vijonë:

I

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e gjashtë (6) automjeteve – Furgon Frigo me të dhënat të cekura me poshtë:

1. Automjet: Daimler Chrysler, Tipi: Furgon Frigo, Viti: 2008, WDB9066331S254695
2. Automjet: Mercedes-Benz, Tipi: Kamion Frigo, Viti: 2006, WDB9702771L79370
3. Automjet: VW, Tipi: Furgon Frigo, Viti: 2005, WV1ZZZ7HZ5H062803
4. Automjet: VW, Tipi: Furgon Frigo, Viti: 2004, WV1ZZZ7HZ5H018450
5. Automjet: Mercedes-Benz, Tipi: Furgon Frigo 2009, WDB9066331S420445
6. Automjet: VW, Tipi: Kombi Frigo 2012, WV1ZZZ2KZCX003470

ku qiramarrësi i merr duke filluar nga data 01.06.2019 për një qmim prej 150.00 euro me TVSH në muaj , kohëzgjatje prej 5 viteve me mundësi vazhdimi .

II

Qiramarrësi merr automjetet -I- të kësaj kontrate me qera, ndërsa Qiradhënësi e jep atë me pagesë duke filluar prej datës së nënshkrimit të kësaj kontrate .

III

Qiramarrësi është i obliguar që pagesën ta bëjë nga data 01 - 05 në çdo fillim muaji për muajin vijues ose sipas marrëveshjes me pronarin

IV

Qiramarrësi është i obliguar që ti kryej të gjitha obligimet që lidhen me automjetet të cekur në piken -I- si p.sh: sigurimin, servisimin, regjistrimin, etj.

V

Qiramarrësi është i obliguar që pas skadimit të kësaj kontrate automjetet e cekura në nenin -I- ta rikthej në gjendje të rregullt dhe ti shlyej të gjitha obligimet si ndaj qiradhënësit ashtu edhe obligimet që janë të cekura nën pikën -IV-, në të kundërtën është i obliguar të vazhdoj që të paguaj qiranë deri sa të rikthejë automjetet në gjendje të rregullt dhe ti kryej të gjitha obligimet.

VI

Qiramarrësi ka të drejtë të ndërpres kontratën duke e paralajmëruar qiradhënësin 1 muaj më heret.

VII

Në rast të mos përmbushjes së kësaj kontrate në tërësi Qiradhënësi do të shiroj padi ndaj Qiramarrësit në organet kompetente.

VIII

Në rast të ndonjë kontesti eventual nga palët kontraktuese, palët u pajtuan që kompetentë të shpallet Gjykata Themelore në Vushtri.

IX

Kjo kontratë u përpilua në 3 ekzemplar identik për nevoja të palëve kontraktuese dhe organet kompetente.



QIRAMARRËSI:

Amazona HOTEL



Edhe dëshmitë pra librezat e regjistrimit me validitet i gjeni në ofertën tonë e që për shkak të volumit të tyre nuk po i pasqyrojmë në këtë kërkesë por vetëm po ja bashkëngjisim si dokumente shtesë.

Pavarësisht kësaj këtë çështje e ka sqaruar shumë mirë Paneli Shqyrtues tek vendimi i datës 05.8.2020 me nr. 475/20 ku ndër të tjera ka theksuar dhe ka mbrojtur edhe pretendimin tonë që tashmë e kemi rreth kësaj çështjeje duke e aprovuar si të bazuar. Veprimi i AK duke vepruar në kundërshtim me ligjin por edhe me vendimin e OSHP-së e bënë edhe më të rëndë shkëljen e nenit 59 të LPP-së. Shihe se çka ka theksua OSHP në vendimin e saj:

Në lidhje me arsyen e tretë të eliminimit paneli shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: OE duhet të ofroj dëshmi- Automjet i mbyllur min 2 cope në emër të OE dhe Pajisjet e nevojshme për ruajtje dhe transport të ushqimit në teren (termoset) minimum 6 cope për ushqime, ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: Lista e mjeteve Dëshmitë- Libreza e regjistrimit të automjeteve me validitet si dhe fotografit- kopje dhe Fotografitë me përshkrim të pajisjeve për bartjen e ushqimit- kopje. Paneli shqyrtues sqaron se OE "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e pajisjeve, ku në këtë listë janë gjithsejtë gjashtë (6) pajisje, me libreza të regjistrimit, si dhe kontratën mbi dhënien e automjeteve me qira, të lidhur me 01.06.2019, në mes me "APETIT SHPK" dhe "AMAZONA HOTEL SHPK", dhe të gjitha këto pajisje janë të pronësi të "APETIT SHPK". Sipas nenit 69.4.5 të LPP-së, kërkesën për pajisjet e kërkuara në dosjen e tenderit, OE munden ta plotësojnë duke dorëzuar: raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve. Poashtu sipas nenit 69.8 të LPP OE munden, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta, andaj paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit ta sqarojë këtë pikë konform nenit 72 të LPP-së.

Pas gjithë kësaj po shihet se AK na ka eliminuar nga konkurrenca pa asnjë arsye dhe se të gjitha dokumentacionet e kontestuara i ka në ofertën tonë saktë ashtu siç edhe i ka kërkuar.

Bazuar në gjithë këto sqarime, argumente dhe fakte që ju ofruam mendojmë se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RROUPP-së me rastin e vlerësimit të tenderit tonë si dhe e ka forcuar shkeljen e tyre edhe më shumë gjatë trajtimit të Kërkesës për Rishqyrtim me çka e ka shkelur edhe nenin 108/A. Gjatë ri-vlerësimit të tenderit tonë por edhe gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim padrejtësisht dhe kundërligjshëm na eliminon nga konkurrenca dhe nuk i përfill pretendimet tona duke vazhduar me shkeljen e ligjit dhe dëmtimin e buxhetit të institucionit përkatës.

Pretendimi 4: AK ka shkelur edhe nenin 60 të LPP-së pasi që si pasojë e mos respektimit të kriterëve dhe kërkesave nga dosje e tenderit si dhe mos respektimin e dispozitave tjera që i potencuam, ka ardhur deri te shkelja edhe e nenit 60 të LPP mbi kriterin e vlerësimit që fitues duhet të shpallet tenderuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Në këtë rast ne kemi pasur çmimin më të ulët për 72,707.20€ si dhe kemi qenë tenderues plotësisht i përgjegjshëm sipas kriterëve nga dosja e tenderit. Shihet qartë pra shkelja e rëndë që AK i ka bërë nenit 60 të LPP-së dhe me këtë veprim rrezikon të dëmtoj buxhetin e vet duke e shkelur edhe nenin 6 të LPP-së mbi shfrytëzimin efikas dhe efektiv të parasë publike. Përpos kësaj kjo bie ndesh edhe me ligjin mbi shfrytëzimin e financave publike dedikuar njësisive buxhetore të shtetit.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që gjatë ri-vlerësimit të tenderit tonë nuk i ka respektuar kërkesat e veta që i ka vendosur në dosjen e tenderit pikërisht duke u bazuar në këtë nen. Nuk ka respektuar më saktësisht kërkesat e 69.4.1 të LPP-së, nenit 69.4.2.ii të LPP-së dhe 69.8 të LPP-së mbi dëshmitë për stafin profesional, dëshmitë për projektet e realizuar si dhe dëshmitë për pajisjet e nevojshme për ofrim të shërbimeve. Pra edhe këtu, nëse dispozitat e tilla krahasojë me veprimet e AK-së shihet qartë se ky i fundit ka vepruar në kundërshtim të plotë me kërkesat e veta dhe nenin 69 të LPP-së

Pretendimi 6: AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së dhe nenin 39 të RRUOPP-së me rastin e sqarimit të tenderëve. AK ka vepruar në kundërshtim edhe me interpretimin e KRPP-së të datës 12.06.2020 që e ka ofruar për publikun pas paraqitjes së kërkesës tonë për interpretim. Ndër të tjera aty thuhet:

Në përputhje me paragrafin 7 të nenit 52 të LPP-së, "Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilido informacion të dorëzuar nga operator ekonomik do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit".

Bazuar në dispozita e lartcaktuara, për tu konsideruar një tender i përgjegjshëm tenderi në fjalë duhet të jetë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Në rast se gjatë procesit të vlerësimit, AK konstaton se OE nuk ka ofruar ndonjë dëshmi në përputhshmëri me atë që është kërkuar në dokumentet e tenderimit, ka të drejtë që në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 59 dhe nenin 72 të LPP-së të kërkojë sqarime me shkrim nga OE, dhe në rast se dyshon në ndonjë informacion të dorëzuar ka të drejtë të kryej një kontroll efektiv të dokumentacionit të tenderit.

Pra sipas nenit 52.7 të LPP-së AK ka të drejt të kryej kontrole për vërtetësinë e dokumenteve që janë të dorëzuara në tender po jo edhe të kërkojë dokumente shtesë siç ka vepruar në rastin tonë.

Pavarësisht kësaj ne ia kemi ofruar AK-së të gjitha dokumentet edhe ne origjinal për verifikim por edhe si të noterizuara për posedim por AK prapë nuk u mjaftua dhe filloi një fushat ndaj klientëve tonë duke iu kërkuar dokumente që nuk i takon ti posedoj dhe duke i kërcënuar se në rast mos bashkëpunimi do ti paraqes tek organet kompetente. Kjo është në kundërshtim me

të gjitha praktikat e mira të prokurimit por edhe në kundërshtim të plotë me nenin 52 dhe 72 të LPP-së si dhe në kundërshtim edhe me nenin 39 të RRUOPP-së.

Pretendimi 7: AK nuk e ka respektua vendimin e OSHP-së me nr. 475/20 të datës 05.08.2020 që i kishte kërkuar për ta ri-vlerësuar tenderin duke i respektuar edhe kërkesat për secilën pikë të pretendimeve tona. Përkundrazi AK e ka injorua plotësisht atë duke vazhduar me kërkesa për sqarime dhe kërkesa për dokumentacione shtesë andaj kjo tregon se AK nuk ka luajtur aspak rol aktiv në respektimin e ligjit dhe vendimeve të lëshuara nga organet kompetente për këtë çështje. Bazuar në këtë e lusim AK që ta përmirësoj gabimin dhe tash ta pranoj kërkesën tonë si të bazuar dhe ta ri-vlerësoj tenderin edhe njëherë duke respektuar LPP dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Në të kundërtën ne do ta dërgojmë prapë lëndën në OSHP dhe nuk mbajmë përgjegjësi për veprimet ndëshkuese që mundet ti merr më pas OSHP-ja.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara, shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes këtë ankesë dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë:

V E N D I M

dhe nxjerrë

U R D H Ë R E S Ë

APROVOHET si e bazuar ankesa e Grupit të OE “AMAZONA HOTEL SHPK & Faton Haziraj B.I.” lidhur me njoftimin mbi vendimin e AK-së për tenderin “Shërbimet e përgaditjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së -Ritender - Vazhdim afati” i iniciuar nga **AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim**.




























Të **URDHËROHET** AK që të bëjë **Ri-vlerësim** duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat e LPP-së e që realisht më pas do duhej që Fitues te shpallej Grupi i OE “AMAZONA HOTEL SHPK & Faton Haziraj B.I.”

9. Dëmet materiale

Përshtetja mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu na bëhet edhe dëmtrim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë shumë të gjatë në fushën e shërbimeve të tilla.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

-  1 B05 Njoftim per Kontrat
-  2 Dosja e RiTenderit - shqip
-  3 PERSHKRIMI I CMIMEVE
-  4 B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara - i fundit
-  5 Procesverbal hapjes se tenderit 15. 05. 2020
-  6 Njoftim mbi vendimin e AK - dhënje 01.07.2020 SKAN (1)
-  7 Interpretimi i KRPP per kerkesat shtese 02.07.2020
-  8 Kerkese per interpretim nga Amazona dorezuar KRPP 01.06.2020
-  9 Kërkesë për monitorim të procesit të prokurimit - 214-19-4346-2-1-1
-  10 Interpretimi i KRPP 12.06.2020
-  11 Kerkesa nga Bekim Dakaj per dergimin e dokumentacioneve origjinale
-  12 Pytja nga Bekim Dakaj drejtuar Klienteve tan
-  13 Kërkesë për rishqyrtim - AKSP 06.07.2020
-  14 Vendimi i AK per Refuzim te KSH-se
-  15 Ankesa - OSHP - AMAZONA - AKSP 17.07.2020
-  16 Fletëpagese dhe Urdhërpagese - AMAZONA HOTEL SH.P.K. - 17.07.2020
-  17 Vendimi i OSHP per rivleresim me nr 475-20
-  18 Kërkesa drejtuar Qendres Kombetare per Njohje Barasvlere dhe Informim Akademik (NARIC)
-  19 Kerkese drejtuar klienteve tone per sqarime shtese
-  20 Njoftim mbi vendimin e AK-dhënje 05.10.2020
-  21 Kerkesa per rishqyrtim - AMAZONA - AKSP 12.10.2020
-  22 Përgjigjja ne Kerkesen per rishqyrtim te OE Amazona Hotel
-  3 Dokumentacioni i Amazona Hotel nr. 1
-  4 Dokumentacioni i Amazona Hotel nr. 2
-  5 Dokumentacioni i Amazona Hotel nr. 3
-  6 Referencat e noterizuara dhe transferet e raiffeisen bank nr. 4
-  7 Transferet e Pro Credit bank nr. 5